



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

---

### V E N D I M

#### PËR DHËNIE AUTORIZIMI PËR NDRYSHIMIN E VENDNDODHJEVE TË DISA QV-VE, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE, TË DATËS 30 QERSHOR 2019

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e tij të datës 29.06.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI -	Anëtar
Edlira	JORGAQI -	Anëtare
Rezarta	BITRI -	Anëtare

shqyrtoi çështjen me:

**OBJEKT:** Për dhënien e autorizimit për ndryshimin e vendndodhjeve të disa qendrave të votimit, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

**BAZA LIGJORE:** Neni 23, pika 1, gërma "a", neni 62, pika 4, neni 93, pika 2, gërma "a", të Ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjo diskutimet e të pranishmëve,

### V E R E N

**Prefekti i Qarkut Shkodër**, me shkresën nr. 13016, datë 29.06.2019, bazuar në ligjin nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", në vlerësim të situatës aktuale, bllokimit të ambienteve të caktuara për vendodhje të QV-ve, i paraqet KQZ kërkesë për të dhënë kryesisht autorizimin për ndryshimin e vendndodhjeve të 16 QV-ve.

**Prefekti i Qarkut Kukës**, me shkresën nr. 13017, datë 29.06.2019, bazuar në ligjin nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", në vlerësim të situatës aktuale, bllokimit të ambienteve të caktuara për vendodhje të QV-ve, i paraqet KQZ kërkesë për të dhënë kryesisht autorizimin për ndryshimin e vendndodhjeve të 2 QV-ve.

**Prefekti i Qarkut Korçë**, me shkresën nr. 13 004, datë 29.06.2019, në ushtrim të përgjegjësi bazuar në ligjin 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", si dhe të dhënave të referuara nga KZAZ nr. 67, i paraqet KQZ-së kërkesën për të dhënë kryesisht autorizimin për ndryshimin e vendodhjeve të 17 QV-ve.



KQZ, në ushtrim të kompetencave përcaktuar në nenin 21, pika 3, të Kodit Zgjedhor, vlerëson situatën dhe propozimet e paraqitura, në funksion të zbatimit të rregullave dhe qetësisë së procesit zgjedhor të datës 30.06.2019.

### **PËR KËTO ARSYE**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 23, pika 1, gërma "a", nenin 21, pika 3, nenin 62, pika 4, neni 93, pika 2, gërma "a", të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar,

### **V E N D O S I :**

1. Dhënien e autorizimit për ndryshimin e vendndodhjeve të QV-ve sipas lidhjes 1 bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor nr.2, nr.3, nr. 11, nr.67, të publikojë menjëherë listat e zgjedhësve në vendndodhjet e qendrave të votimit, caktuar me këtë vendim.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda pesë ditëve nga shpallja e tij.

<b>Klement</b>	<b>ZGURI -</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Denar</b>	<b>BIBA -</b>	<b>Zv/Kryetar</b>
<b>Bledar</b>	<b>SKËNDERI-</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Edlira</b>	<b>JORGAQI-</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta</b>	<b>BITRI</b>	<b>Anëtare</b>

